

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-277/13

**Prishtinë ,  
14 Tetor 2015**

Në çështjen juridike të:

**D. K.**

Mali i Zi

*Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese*

**kundër**

**A. R.**

Gjakovë

*Pala përgjegjëse në kërkesë/ankesë*

Kolegji i Apelit i AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët: Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit ,Rolandus Bruin dhe Krassimir Mazgalov, anëtarë, duke vendosur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/R/199/2013 (dosja e rastit është regjistruar në AKP me numrin KPA28642) i datës 18 prill, 2013, pas seancës gjyqësore të mbajtur më 14 tetor 2015 mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa D. K. paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/R/199/2013 (dosja e rastit është regjistruar në AKP me numrin KPA28642) i datës 18 prill, 2013,
2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/R/ KPPC/D/R/199/2013 (dosja e rastit është regjistruar në AKP me numrin KPA28642) i datës 18 prill, 2013,

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 28 mars 2007, D. K. e ka paraqitur kërkesën në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) duke kërkuar ri posedimin e pronës-banesës që gjendet në Gjakovë, rruga e Skenderbeut ,”Orizare”nr.8 ,hyrja e dytë në sipërfaqe prej 71,90 m<sup>2</sup>. Ai pretendon se ka qenë pronar i kësaj banese sipas kontratës së blerjes së banesës të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Gjakovë, me datën 28 dhjetor 2000.Banesën e ka humbur për shkak rrethanave të konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë, duke theksuar datën e humbjes me 12 qershor 1999.
2. Kërkesa është regjistruar me numër KPA28642
3. Paraqitësi e kërkesës ka paraqitur një sërë dokumentesh tjera, por që nuk janë relevante për këtë çështje juridike.
4. Kontrata e blerjes Vr.nr.48/2000 të datës 28 janar 2000, nuk është verifikuar pozitivisht sipas raportit verifikues i AKP-ës i dt. 23 janar 2009.
5. Më 29 shtator 2008, zyrtarët e AKP-së shkuan te vendi ku ndodhej objekti banesor dhe konstatuan që ai shfrytëzohej nga pala e panjohur.
6. Me datën 06 tetor 2010 pala përgjegjëse në kërkesë, duke marr pjesë në procedurën e AKP-ës, ka pretenduar të drejtën ligjore të kësaj banese duke theksuar se, paraqitësi i kërkesës nuk është titullar i të drejtës pronësore për banesën e kërkuar.
7. Për ta mbështetur pretendimin e tij ka paraqitur këto dëshmi edhe atë:
  - Kontratën mbi bashkimin e mjeteve vetanake për ndërtimin e banesës në bashkëpronësi i datës 30 qershor 1991.

- Me Kontratën e blerjes Nr.497 të datës 17 korrik 1992, konstatohet se pala përgjegjëse në kërkesë e ka blerë banesën që është objekt i kërkesës, në Gjakovë “Orizare 8”, tipi “C”, kati i parë, rr. “Skënderbeu”, në sipërfaqe prej 71,90 m<sup>2</sup>.
  - Me Kontratën e këmbimit të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Gjakovë Vr.nr.448/95 me datën 26 maj 1995, konstatohet se pala përgjegjëse në kërkesë e ka këmbyer banesën që gjendet në rr. “Skënderbeu” p .n të tipit C në sipërfaqe prej 71.90 m<sup>2</sup>, që është objekt i kërkesës me Ndërmarrjen komunale në Gjakovë, ashtu që ia jep këtë banesë, ndërsa Ndërmarrja ia jep në pronësi dhe shfrytëzim lokal afarist në rrugën e “Leninit” nr .22/D në sipërfaqe prej 51,42m<sup>2</sup>.
  - Të gjitha këto dokumente janë verifikuar pozitivisht.
8. Me vendimin e HPCC/D/209/2005/A&C i dt.20 gusht 2005, është miratuar kërkesa e palës përgjegjëse- kërkueses së kategorisë A me nr.DS502337, duke ia kthyer ati të drejtën pronësore për pronën e kërkuar që gjendet në Gjakovë rr.”Skënderbeu”, ”Orizare” 8 nr.1672 , me arsyetim se sipas kontratës së bashkimit të mjeteve ai ka dëshmuar se ka pasur të drejtën valide të banimit dhe se kjo e drejtë është revokuar si pasojë e diskriminimit gjatë periudhës 23 mars 1989 deri më 24 mars 1999. Ndërkaq, paraqitësi i kërkesës së kategorisë C me nr.DS502141 për të njëjtën banesë i është i refuzuar kërkesa. Në arsyetimin e këtij vendimi theksohet se paraqitësi i kërkesës nuk ka deponuar asnjë dëshmi për të treguar se ka pasur ndonjëherë të drejtën e posedimit apo të drejtën e kësaj prone. Dokumentet e paraqitura për të mbështetur pretendimet e tij për të drejtën pronësore nuk kanë mundur të vërtetohen.
9. Me vendimin e HPCC/REC/94/2007, i dt. 26 mars 2007, kërkesa për rishqyrtim e paraqitësit të kërkesës kundër vendimit të HPCC/D/209/2005A&C i dt.20 gusht 2005 , është ndryshuar dhe kërkesat kërkesa e kategorisë A DS502337 dhe kërkesa e kategorisë C Nn.DS502141 janë refuzuar si të pabazuara. Në arsyetimin e këtij vendime theksohet paraqitësi i kërkesës (A. R.) me kontratën e shitblerjes të nr.497 i dt.17 korrik 1992, konstatohet se ai ka blerë banesën që është objekt i kërkesës. Ndërkaq, këtë banesë e ka këmbyer me Ndërmarrja Komunale në Gjakovë. Paraqitësi i kërkesës së kategorisë A ia ka dhënë banesës kontestuese Ndërmarrjes komunale e ajo i ka dhënë lokal afarist. Prandaj ,të dy kërkesat e kategorisë A DS502337 dhe C DS502141, janë refuzuar.
10. Më 18 prill 2013, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KPCC) me vendimin e tij KPCC/D/R/199/2013, e hodhi poshtë kërkesën e D. K. si çështje e gjykuar apo res judicata. Kjo me arsyetim se ,e njëjta kërkesë e tije për të për të njëjtën banesë e

regjistruar në HPCC nr.DS502141, është shqyrtuar dhe vendosur me vendimin e formës së prerë të HPCC/D/209/A&C i dt.20 gusht 2005, duke ia refuzuar kërkesën e kategorisë C si të pabazuar.

- 11.Më 15 gusht 2013, vendimi iu dorëzua paraqitësit të kërkesës dhe i njëjti ushtroi ankesë në Gjykatë Supreme me 12 shtator 2013 (në tekstin e mëtejme: pala ankuese).Ndërkaq , me 05 shtator 2013 vendimin e pranoi pala përgjegjëse në ankesë. Ankesën kjo palë e pranoi me 26 dhjetor 2013, i cili paraqiti përgjigje në ankesë me dt,15 janar 2014.
- 12.Paraqitësi i ankesës e kundërshton vendimin ankimor për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të ligjit material. Ai pretendon se banesën kontestuese e ka fituar në rrugë ligjore, gjë që paraqet edhe dokumentet përkatëse të cilat tashmë i ka paraqitur.
- 13.Në përgjigjen e tij, ai përsëritë pretendimet e njëjta që i kishte bërë para KKPK-së duke theksuar faktin se çështja ishte vendosur nga Drejtorati për Çështje Pronësore Banësore.

#### **Arsyetimi ligjor:**

- 14.Ankesa është e pranueshme ngase është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh siç parashihet me ligj (neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079).
- 15.Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore ,sipas dispozitave të nenit 194 të LPK-ës Gjykata Supreme gjeti se: ankesa është e pabazuar.
- 16.Gjykata Supreme vlerëson se vendimi ankimor është i drejtë dhe ligjshëm. Drejtë ka vepruar KPCC kur ka vendosur me vendimin ankimor që ta hedh kërkesën e D.K. për shkak të çështje së gjykuar apo res judikata sipas nenit 11.4.C të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, KPCC. Kjo ngase, kërkesa e ankuesit është shqyrtuar dhe vendosur me vendimin e plotfuqishëm dhe formës së prerë të HPCC/D/REC/94/2007 i dt.26 mars 2007.Gjykata Supreme vëren se për të njëjtën çështje në mes të njëjtave palë dhe për të njëjtën bazë faktike dhe juridike, është vendosur me këtë vendimin e plotfuqishëm dhe formës së prerë
17. Me këtë vendim të HPCC/D/REC/94/2007 i dt.26 mars 2007 sikundër paraqitësit të kërkesës –ankesës ashtu edhe palës përgjegjëse në ankesë i është refuzuar kërkesa për pranimin e së drejtës së pronës të banesës që është objekt i kërkesës. Për refuzimin e kërkesës HPCC ka dhënë shpjegime të qarta të plota të sakta meritore lidhur me

refuzimin e kërkesave të tyre të specifikuar në paragrafin 8 të këtij aktgjykimi. Prandaj, duke qenë se Komisioni për kërkesa pronësore banesore ka paraqitur argumente të mjaftueshme bindëse për refuzimin e kërkesave të kategorisë A nr.DSS502337 dhe të kategorisë C nr.DSS502141 atëherë gabimisht është përdorur termi juridik se hedhen këto kërkesa në vend që ato refuzohen. Kjo për më tepër ngase në këtë vendim në tekstin në gjuhës shqipe dhe serbe theksohet se këto kërkesa refuzohen.

18. Objekt i shqyrtimit dhe vlerësimit të Gjykatës Supreme ishin pretendimet ankimore të ankuesit se banesën kontestuese e ka fituar në rrugë ligjore, gjë që paraqet edhe dokumentet përkatëse të cilat tashmë i ka paraqitur, por gjeti se, të njëjtat pretendime janë pabazuara të papranueshme dhe rrjedhimisht të kundërligjshme. Kjo ngase, këto pretendime ankimore janë shqyrtuar, vendosur me vendimin e HPCC/D/REC/94/2007 i dt.26 mars 2007 kur është refuzuar kërkesën e tij i cili vendim është res judicata apo çështje e gjykuar.
19. Po kështu, sipas nenit 166 të LPK-ës i cili mutatis mutandis zbatohet sipas nenit 13.5 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, parashikohet se nuk lejohet gjykim i ri në mes palëve të njëjta për çështjen juridike, për të cilën ekziston vendimi i formës së prerë, siç është rasti konkret.
20. Në bazë të gjendjes së tillë të konstatimeve faktike, Gjykata Supreme vlerëson se, tërësisht dhe saktësisht ekziston identiteti, subjektiv, objektiv dhe e njëjta bazë faktike dhe juridike në mes të vendimit të HPCC/D/REC/94/2007 i dt.26 mars 2007 dhe kërkesës së D. K. të paraqitur në AKP me numër të evidencës 28642. Prandaj qartazi rezulton konkludimi juridik se kjo çështje është res judicata.
21. Vendimi ankimor nuk përmban ndonjë gabim të rëndë apo moszbatim serioz të së drejtë materiale dhe procedurale.
22. Rrjedhimisht mbi të mësipërmen e me zbatim të nenit 13.3.B të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 dhe nenit 166 par 2 të LPK-ës u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### **Udhëzim juridik**

23. Sipas Nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50, i amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet me mjete të rregullta dhe ato jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini , Kryetar i Kolegjit

Rolandus Bruin , *Gjyqtar i EULEX-it*

Krassimir Mazgalov , *Gjyqtar i EULEX-it*

Urs Nufer, *Referent i EULEX-it*